

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri DREJTORIA SHENDETIT PUBLIK (DREJTORIA RAJONALE E SHENDETSISE)
GJIROKASTER

Adresa LAGJIA "18 Shtatori" GJIROKASTER

Tel/Fax 084263695

E-mail DRSHgjirokaster@shendetsia.gov.al

Adresa e Internetit

2. Lloji i procedurës se prokurimit: Kërkesë për propozim

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “: “Ruajtja e godinave dhe ambienteve rrethuese te Drejtorise Shendetit Publik Gjirokaster me roje private” - me afat 12 muaj.

Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj

4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-47689-02-14-2018

5. Fondi i Marrveshjes Kuader per 12 muaj- 2.177.178 leke pa TVSH

Public Health Sector

6. Fondi limit per nje vendroje/DITORE- 5964.87 lekë pa TVSH

7. Kohëzgjatja e Marrveshjes Kuader: 12 muaj

8. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data 26.02.2018

Ora 10

9. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data 26.02.2018

Ora 10

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 7 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , te lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
- c. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.3 Kapaciteti teknik

1.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të "Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike", **nënkategoria 1.3.A**, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike", lëshuar nga QKL;
2. Çertifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;
3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Gjirokaster, shoqëruar me vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për numrin mesatar të punonjësve të siguruar për periudhën, Tetor - Dhjetor 2017, gjithashtu shoqëruar me formularin standart E-sig.025 "Listëpagesat e sigurimeve shoqërore". Punonjësit që figurojnë të regjistruar në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, duhet detyrimisht të jenë të regjistruar në listpagesat për periudhën e kërkuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit të ketë një vlerë sa vlera e fondit limit të Marrveshjes Kuader, 2.177.177 leke. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit.

2.3 Kapaciteti teknik

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40%, e vlerës së fondit limit të Marrveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të

operatorit ekonomik .

3. Vertetim nga Drejtorite Vendore te Policise, se SHPSF-ja nuk ka masa administrative, në të gjitha Njësitë Vendore, ku është e rregjistruar, ose ka qenë e rregjistruar sipas Ekstraktit Historik të lëshuar nga QKB per vitet 2016, 2017.
4. Shoqeria duhet te disponoje minimalisht 1 arme brezi, te kategorise “B1”, sipas Ligjit per armet, te disponoje minimimi 1 pergjegjes sherbimi ne vertetim e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Gjirokaster .
5. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Tetor 2017 - Nentor 2017 - Dhjetor 2017) , shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **10 (dhjete) punonjës** të siguruar në muaj, punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.
6. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi qytetin Gjirokaster.
7. Vërtetim nga Njësia Vendore përkatëse, për pagesën e detyrimeve dhe taksave vendore, për vitin 2016, 2017, 2018, në të gjitha Njësitë ku OE është i rregjistruar , ose ka qenë i rregjistruar sipas Ekstraktit Historik të lëshuar nga QKB.
8. Ofertuesi duhet të disponojë se paku **1 (nje) automjet**, për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera. Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit ne pronesi te shoqerise .Ne rastin kur automjeti eshte marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet te shoqerohet edhe me Kontraten noteriale te marrjes me qera, ku te jete percaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qera.
9. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur**. (Shih **Shtojca 1 - Sqarime**)
10. CV e shoqërisë dhe stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.